

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 12.10.2022, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), nenit 63 paragrafi (1) dhe (2), nenit 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Inicativën për miratimin e mendimit juridik parimor, të parashtruar nga Gjoko Gazhoski, avokat nga S., nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa e parashtruar nga Gjoko Gazhoski, avokat nga S., e evidentuar nën Su-03.nr.480/22, me propozim që Seanca e përgjithshme të miratojë mendim juridik parimor lidhur me zbatimin e nenit 1036 dhe nenit 1037 të Ligjit për marrëdhënie obliguese, NUK APROVOHET.

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” numër 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), Seanca e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 12.10.2022 diskutoi mbi Inicativën për miratimin e mendimit juridik parimor Su-03.nr.480/22, e parashtruar nga Gjoko Gazhoski, avokat nga S., ndërsa lidhur me zbatimin e nenit 1036 dhe nenit 1037 të Ligjit për marrëdhënie obliguese.

Në iniciativën propozohet që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë mendim juridik parimor lidhur me zbatimin e nenit 1036 dhe nenit 1037 të Ligjit për marrëdhënie obliguese. Parashtruesi sqaron se kjo është e nevojshme për tu zgjidhur dilema nëse neni 1036 i Ligjit për marrëdhënie obliguese që parasheh se me marrëveshjen e garancisë detyrohet garanti ndaj kreditorit që do ta plotësojë detyrimin e arritur dhe të vlefshëm të debitorit, nëse këtë nuk e bën ky, ka të bëjë edhe me deklaratën e dhënë të njëanshme për garanci të verifikuar në noter, me të cilën një person i caktuar fizik deklaron se garanton për plotësimin e kërkesës së caktuar të cilën debitori e ka ndaj kreditorit, ndërsa në mungesë të marrëveshjes për garancinë. Tërë kjo duke qenë se marrëveshja për garanci është akt dyanësh dhe me të njëjtin është njoftuar edhe vet debitori i cili me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje është pajtuar që garanti të paguajë borxhin që e ka debitori ndaj kreditorit, ndërsa në korrelacion me nenin 1037 nga ligji i sipër theksuar, i cili parasheh se marrëveshja për garanci e detyron garantin vetëm nëse deklaratën e ka bërë me shkrim. Në fakt, në iniciativën parashtruesi absolutisht nuk thekson dhe nuk bashkëngjit praktikë të ndryshme gjyqësore dhe me iniciativën e

parashtruar gjegjësisht kërkon mendim për zbatimin e dispozitave të sipër theksuara ligjore.

Në iniciativën nuk është theksuar asnjë praktikë e ndryshme e bashkëngjitur dhe në fakt nga parashtruesi kërkohet mendim për zbatimin e dispozitave të sipër theksuara ligjore.

Në nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për gjykatat është përcaktuar se Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje me rëndësi për sigurimin e qëndrimit unik në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej tre muajsh, por jo më shumë se gjashtë muaj me iniciativë të tyre ose me iniciativë të kryetarit të gjykatës ose me iniciativë të seancave të gjyqtarëve ose sektorëve gjyqësor të gjykatave.

Duke u nisur nga dispozitat e cituara, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut vlerëson se në rastin konkret nuk rezulton nevoja që të miratohet mendim juridik parimor ngase nuk ka zbatim jo të unifikuar të ligjit, në mënyrë që vijonte që të nxirret Konkluzion me të cilën iniciativa nuk aprovohet.

Gjykata Supreme e
Republikës së Maqedonisë së Veriut
Seanca e përgjithshme